



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 11.35/Prot.  
1

Tiranë, më 29.08.2019

**V E N D I M**

Nr. 30, datë 29.08.2019

“MBI

**MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE SUPLEMENTARE**

**TË STAFIT AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 329 datë 12.04.2017”Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 17, në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL” të ndryshuar pika 7, në Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, në shkresën e FVFR nr. 1066 prot, dt. 15.07.2019 “Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019”; në shkresën e FSHL nr 1066/1 prot, dt. 15.07.2019 “Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019”, në shkresën IKSHS nr. 1068 prot, dt. 16.07.2019 “Realizimi i orëve mësimore, sipas mësimdhënies së normuar vjetore 2018-2019, për efekt pagese”, në Vendimin e Rektoratit nr. 103 datë 23.08.2019”Mbi propozimin e pagesës së orëve suplementare të stafit akademik”, Vendimin e Senatit nr. 33 datë 26.08.2019””Mbi miratimin e propozimit të pagesës së orëve suplementare të stafit akademik, për vitin akademik 2018-2019” dhe në relacionet përkatëse, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 30.08.2019,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin pagesës së orëve suplementare të stafit akademik të tre njësave kryesore të UST, për vitin akademik 2018-2019, nga art 600.8 i buxhetit të Universitetit Sporteve të Tiranës.
2. Miratimin e pagesës së stafit akademik për orën mësimore sipas pikës 7, të VKM nr. 748 datë 11.06.2009”Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT ADMINISTRIMIT**

